



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, merr;

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 50,300.00€, ndihmë për dyqindpesëdhjetepesë (255) personave me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike -sociale sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/04-004611/24
Podujevë, datë 01.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Builqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot.02-111/01-0014518/24, datë 29.02.2024, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E ZËVENDËS DREJTORIT / ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "SHABAN SHALA" NË PODUJEVË

Neni 1

znj.Ajshe Mehmeti, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted] nga fshati Brainë Komuna e Podujevës, e kualifikuar *Bachelor i gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*,

Emërohet përkohësisht në pozitën Zëvendës Drejtoreshë e SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë.

Neni 2

E përmendura sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e zëvendës Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtoria e Arsimit
Të emëruarës
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-111/01-0015065/24
Podujevë, datë: 01-03-2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 15 paragrafi 1.7 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 05-400/04-0013809/24, të datës 27.02.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Gani Sheholli nga Podujeva, për botimin e monografisë së shkollës së mesme teknike "Fan S. Noli" Podujevë, mbështetet me mjete financiare në shumë 1500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Gani Sheholli (njoftohet përmes DKA-së).

Nr.prot 02-400/04-0016418/24
Podujevë, datë, 06.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat f) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, në zbatim të Marrëveshjes nr.prot.02-016/01-0073448/23 të datës 06.10.2023, Lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e “Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuar Kuzhinë Humanitare dhe Bujtinë”, në Podujevë, merr:

V E N D I M

I

znj. Flaka Ademi, zyrtar në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, caktohet menaxhere nga Komuna e Podujevës, për mbikëqyrjen e punimeve në kuadër të projektit për ndërtimin e Objektivit “Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuar Kuzhinë Humanitare dhe Bujtinë” në Podujevë, i cili realizohet sipas Marrëveshjes nr.prot.02-016/01-0073448/23 të datës 06.10.2023 të lidhur nga Komuna e Podujevës dhe Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”

II

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

I'u dërgohet:

Të caktuarës,

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS

Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit - DPUMM

Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” për njoftim - përmes DSHMS

QSHQ / Arkivit

Zyrës së Personelit

Nr.Prot: 02-020105-0016415124
Podujevë, datë, 06.03.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 4.6 të Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenet 16 dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 02-020/04-0011859/24, DATË 16.02.2024

Neni 1

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi për ngritjen e komisionit për vlerësimin e pasurisë jo financiare të Komunës së Podujevës nr. prot. 02-020/04-0011859/24, datë 16.02.2024 dhe atë:

Në vend të **Alban Shabani**, në përbërjen e komisionit caktohet **Lutfi Kastrati**.

2. Pjesa tjetër e Vendimit bazë, të cekur si në paragrafin 1 të këtij neni mbetet e pandryshuar.

Neni 2

Zëvendësimi dhe ndryshimet bëhen për shkak se zyrtari Alban Shabani është anëtar i Komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare të Komunës së Podujevës sipas vendimit nr.prot.02-020/04-0103660/21, datë 24 nëntor 2021, gjendje kjo e cila paraqet konflikt të interesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0017012/24
Podujevë, datë: 08.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 ndërlidhur me nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.08/L-114 për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, nenit 16, ndërlidhur me nenin 20 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Agjencionit të Statistikave të Kosovës dërguar përmes e-mailit të datës 08.03.2024, nxjerrë:

V E N D I M

Neni 1

Anëtar në kuadër të komisionit për përzgjedhjen e regjistruessve, nga Komuna e Podujevës emërohen:

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
z.Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Neni 2

Komisioni dhe përbërja e komisionit për përzgjedhjen e regjistruessve sipas Ligjit nr.08/L-114 për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, ndër të tjera cakton kriteret për përzgjedhjen e koordinatorëve, monitoruesve, mbikëqyrësve dhe regjistruessve; emëron koordinatorët, monitoruesit dhe mbikëqyrësit nëpër Komisionet Komunale të Regjistrimit; harton listën e ngushtë për regjistruess, si dhe merr pjesë në përzgjedhjen e tyre, ndërsa Komisioni Komunal i Regjistrimit, merr pjesë në përzgjedhjen e regjistruessve në Komunë, sipas njoftimeve përkatëse në bashkëpunim dhe koordinim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit

Me këtë Njoftohen:

Agjencia e Statistikave të Kosovës
Anëtarët e Komisionit sipas këtij Vendimi
QSHQ/Arkivi

Nr.Prot. 02-020/04-097060/24
Podujevë, datë, 11.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

Autorizohet z.Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Inspeksionit, derisa z.Alban Zeka, Drejtor i Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 11.03.2024 deri më 23.03.2024.

Nr.prot. 02-016/01-0017061/24
Podujevë, datë: 11.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 1.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas konkursit nr.05/52 të datës 20.02.2024 për ndarjen e bursave për Studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2023-2024, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Selman Gashi , zyrtar për çështje pedagogjike – Drejtorja e Arsimit	kryesues
Bahrie Talla , drejtoreshë në SHFMU “Hyzriu e Samiu” - Letanc	anëtare
Blerim Vilasa , zyrtar për arsimin e mesëm të lartë – Drejtorja e Arsimit	anëtar

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Arsimit
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0017117/24
Podujevë, datë, 11.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0014131/24, të datës 28.02.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.**Liza Duriqi** nga Podujeva, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të vajzës së saj dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.

QSHQ/Arkivit.

znj.Liza Duriqi (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/04-0017527/24
Podujevë, datë, 12.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.04-400/04-0016749/24 të datës 07.03.2024, të OJQ-“Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, të proceduar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ- “ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS”

Neni 1

OJQ – “Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, për mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve të shoqatave, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ – “Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendim.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/04-0017746/24
Podujevë, datë 13.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpirtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040, nenet 16 dhe 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 dhe nenet 3 parag. 3 dhe 27 paragrafi 1.2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Proceduarat e Ndarjes së Subvencioneve nr. 01-016/01-0030667/22, në rekomandim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.02-052/09-0012540/24, datë 21.02.2024, merr:

VENDIM PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme 3200 € për aktivitetet e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, përkatësisht zgjedhjen e sportistëve të vitit 2023 në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe destinohen për përzgjedhurit/sportistë të vitit, sipas specifikacioneve përkatëse të datës 27.12.2023, në kuadër të rekomandimit të cekur nga DKRS.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit të cilat obligohen për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore sa i përket shpenzimit të parasë publike.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/04-0017752/24
Podujevë, datë: 13.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 14.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 21.1 të Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nxjerr:

VE ND I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË JO FINANCIARE TË KOMUNËS

Neni 1

Ngritet Komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare të Komunës, në përbërje:

Latif Mehmeti	kryesues
Haxhere Ajvazi	anëtar
Lutfi Kastrati	anëtar
Rrahim Berisha	anëtar
Ardonis Jusufi	anëtar

Mandati i komisionit është dy vite.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren MF- nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot.02-020/04-0011859/24, datë 16.02.20224 me ndryshim plotësimet përkatëse.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave

QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0017854/24
Podujevë, datë: 14.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafi 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VEÇANTË PËR RASTET DHE KËRKESAT INDIVIDUALE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për rastet dhe kërkesat individuale të cilat paraqiten jashtë thirrjeve publike, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Makfirete Zeka,	kryesues - <i>Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.</i>
Blerim Vllasa,	anëtar - <i>Drejtoria e Arsimit.</i>
Shefrie Gashi,	anëtare - <i>Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.</i>
Rilind Babatinca,	anëtare - <i>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik..</i>
Blerina Fejzullahu,	anëtare - <i>Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.</i>

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot 02-020/04-0054227/22 i datës 04.07.2022 me plotësim ndryshimet e bëra.


U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorive perkatëse
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot 02-020/04-0017955/24
Podujevë, datë 14.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11,13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 6 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 10 të Rregullores komunale nr. prot. 01-462/01-0062841/22 datë 29.07.2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një(1) vit të pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 14, 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr;

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim më pak se një (1) vit, si vijon:

Ardiana Dibrani, udhëheqëse e sektorit për çështje pronësore juridike në DPKGJ
Kujtim Zhitia, zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Blerina Fejzullahu, zyrtare në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit
Ragip Jaholli, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave
Blerina Zeka, zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kryesues i Komisionit do të jetë zyrtari nga Drejtoria të cilës i është drejtuar kërkesa për marrje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi vepron në përputhje me rregullativën përkatëse ligjore në fuqi, me theks Rregulloren komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, ndër të tjera duke bërë shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen e kërkesave për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, përgatitjen e raportit përfundimtar, përfshirë edhe rekomandimin për palën e përzgjedhur/përfituese së bashku me Kontratën e cila nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i pronës.

Neni 3

Mandati i komisionit është dy (2) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-020/04-0082250/22 datë 22.09.2022.

U dërgohet;
Drejtorive përkatëse dhe anëtarëve të komisionit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0017971/24
Podujevë, datë: 14.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpetim Balliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr. 02-615/03-0017563/24, datë 13.03.2024, nxjerr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Neni 1

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ - ve në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive ofrohet nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-600/04-0018040/24
Podujevë, datë: 14. 03. 2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 15.03.2024, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0013313/24 të datës 26.02.2024, për përkrahje në projektin për kultivimin e feferonave, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| - Shefrije Gashi , zyrtare për prodhimtari bimore - DBPZHR | kryesuese |
| - Ymer Hoti , udhëheqës i sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural - DBPZHR | anëtar |
| - Mensur Hoti , zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme – DBF | anëtar |

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr. prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 01-020/04-0018251/24
Podujevë, datë, 15.03.2024



Kryetari i Komunës
Shejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Ligjit nr. 08/L-114 për Regjistrimin e Popullsisë Ekonomive Familjare dhe Banesave, nenit 3 të Rregullores për Funksonimin e Komisionit Komunal të Funksonimit nr. 01-01-2023 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR REGJISTRIMIN E POPULLSISË EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE**

Neni 1

Për regjistrimin e popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në territorin e Komunës së Podujevës, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, kryesues
z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, anëtar
z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, anëtar
z. Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar
znj. Xhevrie Beqiri, Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, anëtare
znj. Lirie Hoti, Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar
z. Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtar
z. Mexhit Hasani, Përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, anëtar
z. Shqipdon Rashiti, nga shoqëria civile, anëtar
z. Fitim Sejdiu, përfaqësues i komuniteteve jo shumicë, anëtar
z. Fitim Humolli, Prof. Ass. Dr. i Gjeografisë, anëtar

Neni 2

Komisioni vepron dhe angazhohet në punët dhe aktivitetet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 08/L-114 për Regjistrimin e Popullsisë Ekonomive Familjare dhe Banesave, Rregullores për Funksonimin e Komisionit Komunal të Funksonimit dhe akteve tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi që ndërlidhen me fushën e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. 02-020/04-0006218/23 datë 23.01.2023 për ngritjen e komisionit për regjistrimin e popullsisë ekonomive familjare dhe banesave, me ndryshim plotësimet përkatëse.

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
ASK-së
QSHQ/ Arkivit

Nr. prot. 02-052/02-0018250/24
Podujevë, datë: 15.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.04-400/04-0016749/24 të datës 07.03.2024, të OJQ-“Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, të proceduar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ- “SHOQATA E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE TË UÇK-SË DEGA PODUJEVË”

Neni 1

OJQ – “Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së- Dega Podujevë”, për mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve të shoqates, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ – “Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së- Dega Podujevë”.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/04-0018582/24
Podujevë, datë 13.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.04-400/04-0016749/24 datë 07.03.2024 të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Dega Podujevë, të proceduar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE SHOQATËN E INVALIDËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS-UÇK DEGA PODUJEVË

Neni 1

Shoqata e Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-UÇK-së Dega Podujevë, për zhvillimin e aktiviteteve mbështetet me mjete financiare, në shumë 500 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për zhvillimin e aktiviteteve të Shoqatës të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-UÇK-së Dega Podujevë.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/04-0018577/24
Podujevë, datë 19.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, si dhe në implementim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, e lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamiërse “Jetimat e Ballkanit” nr.prot.02-016/01-0018437/24 të datës 18.03.2024, në bashkëpunim dhe koordinim me Shoqatën e cekur, merr këtë;

V E N D I M

Neni 1

Formohet komisioni i përbashkët ad-hoc për përzgjedhjen e 5 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, përfituese të shtëpive të banimit që do të ndërtohen nga Shoqata Bamiërse “Jetimat e Ballkanit”, në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Komunën e Podujevës, në këtë përbërje;

- **Arbresha Bashota**, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kryesuese
- **Arbër Sfishta**, Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit, anëtar
- **Rinor Hakaj**, përfaqësues nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, anëtar
- **Ferid Ibrahim**, përfaqësues nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, anëtar

Neni 2

Punët dhe detyrat e komisionit ndër të tjera janë, verifikimi i aplikacioneve / kërkesave të paraqitura për ndërtimin e shtëpive të banimit, vlerësimi i tyre si dhe përzgjedhja e 5 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit, përfituese të shtëpive të banimit që do të ndërtohen nga Shoqata Bamiërse “Jetimat e Ballkanit” në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Komunën e Podujevës, sipas Marrëveshjes përkatëse të Bashkëpunimit nr.prot.02-016/01-0018437/24 të datës 18.03.2024 e lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamiërse “Jetimat e Ballkanit”

Neni 3


Për punën e kryer komisioni përgatit Raport në formë të shkruar dhe të njëjtin ia dorëzon Kryetarit të Komunës dhe një kopje Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet;
Anëtarëve të Komisionit, përmes DSHMS
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS
Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, përmes DSHMS
QSHQ/Arkivës

Nr.Prot. 02-020/05-0018623/24
Podujevë, datë: 19.03.2024



Kryetari i Komunës
Shpërtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 15 paragrafi 1.8 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 05-400/04-0017114/24, të datës 11.03.024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Rrezon Hoxha nga fshati Obrancë për arritjen e suksesit në garat në lëndën e Fizikës, si nxënësi më i dalluar në nivel të shkollës “Aleksandër Xhuvani” Podujevë, si dhe në nivelin qendror, mbështetet me mjete financiare në shumë 400.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e znj.Zyhrije Hoxha e ëma e të përmendurit

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Rrezon Hoxha (njoftohet përmes DKA-së).

Nr.prot 05-400/04-0018812/24
Podujevë, datë, 19.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 63.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nenin 19 parag. 2.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe nenin 65.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Formularit për deklarimin e e konfliktit të interesit të znj. Ardiana Dibrani nr. prot 02-466/02-0018626/24, datë 19.03.2024, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr. 02-020/04-0017971/24 datë 14.03.2024 për formimin e Komisionit vlerësues, dhe atë:

Në vend të znj. Ardiana Dibrani, anëtar në komisionin vlerësues caktohet z. Mensur Hoti.

Neni 2

Zëvendësimi i anëtarit të komisionit bëhet ad hoc, vetëm për rastin e vlerësimit/shqyrtimit të kërkesës nr. prot. 08-334/07-0013685/24 datë 27.02.2024 të specifikuar në formularin e deklarimit të konfliktit të interesit, ku e njëjta ka kërkuar të lirohet nga cilësia e anëtares së komisionit për shkak të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

UI dërgohet:
Zyrtarit të caktuar
Drejtorëve të Drejtorive përkatëse
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0018930/24
Podujevë, datë: 19.03.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 shkronja f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 , 16 dhe 61 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 - 0050862/18, sipas kërkesës në formë elektronike të z. Pajtim Balaj, datë 29.03.2024, merr:

V E N D I M PËR LIRIMIN NGA DETYRA E DREJTORIT TË DREJTORISË SË KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Neni 1

z. Pajtim Balaj, lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga detyra e drejtorit sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet në kërkesë të të përmendurit për lirim nga detyra përkatëse, për shkak të angazhimit profesional në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-113/02-0020904/24
Podujevë, datë: 29. 03. 2024



Kryetari i Komunës
Shejtim Bulliqi